

VENDIM
Nr. 541, datë 9.10.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“RIVITALIZIMI I RRUGËS “DËSHMORËT”, ÇOROVODË”, NË BASHKINË E
SKRAPARIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rivitalizimi i rrugës “Dëshmorët”, Çorovodë”, në Bashkinë e Skraparit.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Skrapar.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë me sipërfaqe prej 18 m² “truall,” dhe 26 m² “ndërtesë”, me vlerë të përgjithshme prej 932 552 (nëntëqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e dy) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 932 552 (nëntëqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e dy) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Skrapar, planifikuar në buxhetin e saj.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Skrapar.
 6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë Skrapar të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.
 8. Regjistrimi i ri i pasurive prej 18 m² “truall” dhe 26 m² “ndërtesë”, për projektin “Rivitalizimi i rrugës “Dëshmorët”, Çorovodë”, në Bashkinë e Skraparit, të bëhet në favor të Bashkisë Skrapar.
 9. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Skrapar dhe Bashkia Skrapar për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E
PROJEKTTIT “RIVITALIZIMI I RRUGËS “DËSHMORËT”, ÇOROVODË”, BASHKIA SKRAPAR

[illegible]